

## V E N D I M

### P Ë R

SPECIFIKIMET DHE PËRMBAJTJEN E KODIFIKIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 86, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

### V E N D O S I:

1. Grupimin e programeve të studimit, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, sipas elementeve të mëposhtme:
  - a) Identifikimi i llojit të programit të studimit. Ky element përmban 4 (katër) karaktere, ku përcaktohet niveli i tij referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, kohëzgjatja e programit të studimit dhe lloji i programit;
  - b) Fusha e detajuar, në të cilën bën pjesë programi i studimit. Ky element përbëhet nga 4 (katër) shifra, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, referuar Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit 2011 (KSNA 2011), Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (KSNA-F 2013);
  - c) Një shkronjë, e cila identifikon gjuhën në të cilën zhvillohet programi i studimit, sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Identifikimi i llojit të programit të studimit përcaktohet, si më poshtë vijon:
  - a) Programe studimi me karakter profesional me 60 ECTS (51PP);
  - b) Programe studimi me karakter profesional me 120 ECTS (52PP);
  - c) Bachelor, jo më pak se 180 ECTS (63BA);

- ç) Master profesional me 60 ECTS (71MP);
- d) Master profesional me 120 ECTS (72MP);
- dh) Master i shkencave, jo më pak se 120 ECTS (72MS);
- e) Master i arteve, jo më pak se 120 ECTS (72MA);
- ë) Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë me 300 ECTS (75MI);
- f) Program i integruar i studimeve të ciklit të dytë me 360 ECTS (76MI);
- g) Master ekzekutiv me 60 ECTS (81ME);
- gj) Master ekzekutiv me 120 ECTS (82ME);
- h) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, me 120 ECTS, (82SA);
- i) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me 180 ECTS, (83SA);
- j) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 4 vite akademike, me 240 ECTS, (84SA);
- k) Specializim afatgjatë, me kohëzgjatje 5 vite akademike, me 300 ECTS, (85SA);
- l) Doktoratë (83DO).

3. Për programet e studimit, të cilat ofrohen me kohë të zgjatur, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, në fillim të kodit shënohet shkronja “Z”.

4. Për programet e përbashkëta të studimit, përveç elementeve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, në fillim të kodit shtohet shkronja “P”.

5. Për programet e studimit të formimit të vazhduar, elementet e kodit, që përcaktojnë identifikimin e llojit të programit të studimit, përbëhen nga lloji i programit të studimit “SFV” (studim i formimit të vazhduar). Elementet e tjera të kodifikimit për këto programe studimi janë sipas përcaktimeve të shkronjave “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij vendimi.

6. Vlerësimi i fushave të programeve të studimit ndërdisiplinor dhe rasteve të veçanta kryhet në përputhje me rregullat e përcaktimet e referuara në Fushat e Arsimit dhe Trajnimit 2013 (KSNA-F 2013).

7. Për programet ekzistuese të studimit, institucionet e arsimit të lartë dërgojnë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për arsimin, propozimin/et e tyre të argumentuar/a lidhur me kodet, që

duhet të përmbajnë të gjitha programet e studimit që ato ofrojnë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

8. Për programet e reja të studimit, kodi i programit të studimit përfshihet në aplikimin e institucionit të arsimit të lartë për hapjen e programit të studimit dhe vlerësohet nga ministria përgjegjëse për arsimin në funksion të procedurave për hapjen e programit të studimit.

9. Kodifikimi i programeve të studimit kryhet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programet që do të kodifikohen, bazuar në procedurat e miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (INSTAT) raporton statistikatat e arsimit të lartë, sipas këtij vendimi.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A